



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:168891

Datë: 17.05.2021

Numri i dokumentit: 01782872

**Ae.nr.104/21**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike**, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Rrustem Thaqi, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses “[P...]”, me seli në Turqi, të cilin e përfaqëson me autorizim avokati “[N.P.]” nga Prishtina, kundër të paditurës “[E...]” sh.p.k., me seli në Prizren, për kompensim borxhi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditëses e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.617/20 e datës 16/03/2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **05/05/2021**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**APROVOHET** e themeltë ankesa e paditëses “[P...]”, me seli në Turqi dhe **ANULOHET** aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike I.EK.nr.617/20 e datës 16/03/2021 dhe çështja kthehet në rigjykim në gjykatën e shkallës së parë.

**A r s y e t i m**

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin ankimor I.EK.nr.617/20 e datës 16/03/2021, ka vendosur si në vijim:

I.Ndërpritet procedura në këtë çështje kontestimore, për shkak të vdekjes së përfaqësuesit ligjor të palës së paditur.

II.Procedura e ndërprerë mund të vazhdoj, po që se pasardhësit e personit juridik e marrin përsipër procedurën, kur gjykata i fton të njëjtit ta bëjnë një gjë të tillë apo me propozimin e palës kundërshtare.

Kundër këtij aktvendimi, paditësja ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljeve thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, ndërsa aktvendimi ankimor të anulohet dhe lënda të kthehet në rivendosje.

E paditura nuk ka dhënë përgjigje në ankesë.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktvendimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 e lidhur me nenin 208 dhe 505.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (në vijim LPK), ka gjetur se:

**-Ankesa është e themeltë.**

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja “[P...]”, me seli në Turqi, pran Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 02/12/2020, ka paraqitur padi, kundër të paditurës “[E...]” sh.p.k., me seli në Prizren, për kompensim dëmi, me kërkesë të përshkruar si në kërkesëpadi.

Gjykata e shkallës së parë gjatë shqyrtimit gjyqësor ka konstatuar se përfaqësuesi ligjor i të paditurës ka vdekur me datën 22/01/2021 dhe meqenëse pala është person juridik e njëjta ka pushuar së ekzistuari, nga këto arsye e duke u bazuar në nenin 278.1 pika d) dhe neni 280 të LPK-së ka vendosur si në dispozitivin e aktvendimit të atakuar.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është i drejtë dhe si i tillë nuk mund të pranohet, pasi që aktvendimi i atakuar është i përfshirë në shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore të paraparë me nenin 182 par.1 e lidhur me nenin 277 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, qëndrojnë si të themelta pretendimet ankimore të palës paditëse, për arsye se në shkresat e lëndës nuk gjendet ndonjë vendim nga ARBK-ja për çregjistrimin e të paditurës apo ndonjë vendim nga organi kompetent të formës së prerë me të cilën ju ndalohet aktiviteti ekonomik të paditurës, po ashtu në shkresat e lëndës nuk ka ndonjë provë se ndaj të paditurës ka filluar procedura e falimentimit, andaj në rastin konkret nuk janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 277 të LPK-së që procedura kontestimore të ndërpritet, për arsye se me nenin 75.1 të Ligjit për Shoqëri Tregtare është paraparë: *Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është person juridik e cila është juridikisht e ndarë nga aksionarët. Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar është vetvetiu bartëse e të drejtave dhe obligimeve, ndërsa me nenin 112 të po këtij ligji, janë paraparë rastet kur mund të*

shpërbëhet një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar, andaj në rastin konkret gjykata e shkallës së parë gabimisht e ka zbatuar nenin 278 par.1 pika d) të LPK-së e cila pikë e kësaj dispozite nuk ekziston në ligjin procedural. Andaj, shkeljet e tilla përfaqësojnë shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore që kanë pasur ndikim në marrjen e aktvendimit të ligjshëm dhe të drejtë, andaj aktvendimi i atakuar doemos është dashur të anulohet.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë ka bërë shkeljen e dispozitës së sipërcituara, të cilat në ri procedurë duhet të eliminohen në atë mënyrë që të zbatohen drejte dispozitat e procedurës kontestimore dhe të merr një vendim i drejtë dhe i ligjshëm.

Nga të cekurat më lartë, e në mbështetje të dispozitave të nenit 208 dhe 209 pika d) e LPK-së, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË**  
**-Departamenti për Çështje Ekonomike-**  
**Ae.nr.104/21, me datën 05/05/2021**

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari  
Liridon Maloku